



**QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËS DHE E POLITIKËS SOCIALE**

LAJMËRIM

për shfrytëzimin e shërbimit vikend turistik falas për përfituesit e pensionit, për vitin 2015

Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale u bën thirrje të gjithë pensionistëve të interesuar që të paraqiten për shfrytëzimin e shërbimit vikend turistik falas për përfituesit e pensionit për vitin 2015.

Këtë shërbim mund të shfrytëzojnë personat-pensionistët që marrin pension pleqërie, pension invalidor dhe pension familjar që e kanë fituar sipas normave të Republikës së Maqedonisë dhe normave nga marrëveshjet për sigurim social që Republika e Maqedonisë i zbaton, e të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe drejtën e pensionit e kanë arritur përfundimisht me dhjetorin e vitit 2014.

Ky shërbim mund të shfrytëzohet vetëm një herë, në periudhën prej në prill deri në nëntor të vitit 2015, në kohëzgjatje prej 3 ditëve dhe i njëjti përfshinë:

- 2 pansione të plota (2 net fjetje me tri racione), respektivisht arritja bëhet ditën e premte pasdite, kurse kthimi ditën e diel pasdite dhe
- transport me autobus deri te objekti hotelerik.

Objektet hotelerike ku do të dërgohen shfrytëzuesit e pensionit gjenden në qytetet respektivisht vendet, si vijon: Ohër, Strugë, Dojran, Krushevë, Prespë dhe Berovë.

Pensionistët që shfrytëzojnë edhe kompensime në të holla për ndihmë dhe përkujdesje nga person tjetër, shtesë për mobilitet apo verbësi kanë të drejtë për shoqëruar gjatë shfrytëzimit të këtij shërbimi.

Termimi i lejuar për shfrytëzimin e këtij shërbimi nuk mund të ndryshohet, përveç në rastet kur paraqiten pengesa për shkak të sëmundjes.

Dokumentet e nevojshme që përfituesi i pensionit duhet t'i dorëzojë për shfrytëzimin e këtij shërbimi:

Për shfrytëzimin e shërbimit rekreacion klimaterik në banja pensionistët duhet të parashtrajnë **kërkesë** në Njësinë rajonale të Fondit për Sigurim Pensionsal dhe Invalidor të Maqedonisë, sipas vendbanimit të tyre. Kërkesën e jep Njësia Rajonale e Fondit.

Në kërkesë përfituesi i pensionit mund të përcaktohet ta shfrytëzojë shërbimin e vikendit turistik falas për përfituesit e pensionit për vitin 2015 apo shërbimin rekreacion klimaterik në banjë për përfituesit e pensionit për vitin 2015.

Nëse përfituesi i pensionit shfrytëzon edhe pjesë nga pensioni të cilin e merr nga ndonjë shtet tjetër, **doemos** duhet të parashtrrojë edhe çekun nga banka për shumën mujore të pensionit.

Gjatë rangimit të kërkesave të parashtruara, prioritet do t'u jepen pensionistëve të cilët para pensionimit kanë punuar në miniera dhe pensionistëve që janë përfitues të pensionit invalidor me invaliditet të lartë të përcaktuar.

Kërkesat mund të parashtrohen deri më 16 shkurt të vitit 2015

Pas përfundimit të procedurës, Fondi i Sigurimit Pensionsal dhe Invalidor të Maqedonisë me shkrim do ta informojë parashtruesin e kërkesës për objektin hotelerik ku do të dërgohet dhe për periudhën e shfrytëzimit të këtij shërbimi.

Listat e përfituesve të pensionit, të cilëve u është miratuar shfrytëzimi i këtij shërbimi do të publikohen në Njësitë Rajonale të Fondit, si dhe në ueb faqen e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale www.mtsp.gov.mk dhe në ueb faqen e Fondit për Sigurim Pensionsal dhe Invalidor të Maqedonisë www.piom.com.mk

Theksojmë se personat-përfituesit e pensionit të cilët në vitin 2014 e kanë fituar të drejtën t'i shfrytëzojnë shërbimet e rekreacionit klimaterik në banja, nuk mund të shfrytëzojnë shërbimin vikend turistik falas për përfituesit e pensionit për vitin 2015.

MINISTRIA E PUNËS DHE E POLITIKËS SOCIALE